



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА - REPUBLIKA E MAQEDONISE SE VERIUT
НАЦИОНАЛНА УСТАНОВА - АРХЕОЛОШКИ МУЗЕЈ
НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА - СКОПЈЕ
INSTITUCIONI NACIONAL - MUZEU ARKEOLOGJIK
I REPUBLIKES SE MAQEDONISE SE VERIUT - SHKUP

Бр.-Nr.

04-712/2

17.06

2026 год.-viti

СКОПЈЕ - SHKUP



НУ Археолошки музеј на Република Северна Македонија – Скопје /

IN Muzeu arkeologjik i Republikës së Maqedonisë së Veriut-Shkup

Kej Димитар Влахов 66 – Скопје / Kej Dimitar Vlahov p.n. - Shkup

тел. / tel. ++389 2 3233999

e-mail: contact@amm.org.mk

Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 62/05, 106/08, 161/08, 114/09, 130/09, 149/09, 50/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15, 27/16 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 110/2019 dhe nr. 74/25), nenit 77-a, paragrafi 1, 2 dhe 5, neni 77-b, paragrafi 1, neni 77-c, neni 77-d dhe neni 77-dh të Ligjit për kulturë (Gazeta Zyrtare e RM nr. 31/98, 49/03, 82/05, 24/7, 116/10, 47/11, 51/11, 136/12, 23/13, 187/13, 44/14, 61/15, 154/15, 39/16, 11/18), nenit 20-d të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik (Gazeta Zyrtare e RM nr. 27/14, 199/14, 27/16, 35/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 143/19 dhe 14/20) dhe në pajtim me Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës në Institucionin Nacional Muzeu arkeologjik i Republikës së Maqedonisë së Veriut - Shkup nr. 01-509/1 nga 20.08.2020, si dhe Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në IN Muzeu arkeologjik i Republikës së Maqedonisë së Veriut-Shkup nr. 01-49/1 nga 21.01.2021, Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në IN Muzeu arkeologjik i Republikës së Maqedonisë së Veriut-Shkup nr. 01-163/1 nga 16.02.2021, Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në IN Muzeu arkeologjik i Republikës së Maqedonisë së Veriut-Shkup nr. 01-424/1 nga 28.05.2021, Rregulloren për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në IN Muzeu arkeologjik i Republikës së Maqedonisë së Veriut-Shkup nr. 01-618/1 nga 18.08.2021, Rregulloren për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në IN Muzeu arkeologjik i Republikës së Maqedonisë së Veriut-Shkup nr. 01-811/1 nga 30.11.2021, Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës në IN Muzeu arkeologjik i Republikës së Maqedonisë së Veriut-Shkup nr. 03-498/3 nga 27.06.2022 dhe Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës në IN Muzeu arkeologjik i Republikës së Maqedonisë së Veriut-Shkup nr. 01-775/1 nga 02.11.2022, Rregulloren për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në IN Muzeu arkeologjik i Republikës së Maqedonisë së Veriut-Shkup nr. 01-566/1 nga 01.08.2023, Rregulloren për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në IN Muzeu arkeologjik i Republikës së Maqedonisë së Veriut - Shkup nr. 01-1067/1 nga 20.12.2024, Rregulloren për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në IN Muzeu arkeologjik i Republikës së Maqedonisë së Veriut - Shkup nr. 01-559/1 nga 05.06.2025 dhe Rregulloren për ndryshim dhe plotësim të Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në IN Muzeu arkeologjik i Republikës së Maqedonisë së Veriut - Shkup nr. 01-179/1 nga 12.02.2026 dhe Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në IN Muzeu Arkeologjik i Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup, nr. 01-636/1, datë 20.05.2026, Rregulloren për elementet e detyrueshme të shpalljes publike për plotësimin e vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe të fletëparaqitjes për punësim, si dhe formën, përmbajtjen dhe mënyrën e

mbajtjes së regjistrit të personave që kanë dhënë të dhëna të rreme gjatë punësimit në sektorin publik (Gazeta Zyrtare e RM nr. 34/15), Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e shpalljes publike dhe të fletëparaqitjes për punësim, mënyrën e realizimit të seleksionimit, mënyrën e realizimit të intervistës, si dhe mënyrën e pikëzimit varësisht nga kategoria dhe niveli i vendit të punës për të cilin është shpallur shpallja publike në Institucionin Nacional Muzeu arkeologjik i Republikës së Maqedonisë së Veriut - Shkup nr. 02-771/3 nga 19.08.2024 dhe njoftimet për mjetet financiare të siguruara nga Ministria e Financave e RMV-së nr. 19-4803/2 nga 16.06.2026, Institucioni Nacional Muzeu arkeologjik i Republikës së Maqedonisë së Veriut - Shkup, shpall:

SHPALLJE PUBLIKE nr. 04/2026

Institucioni Nacional Muzeu Arkeologjik i Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup ka nevojë për punësimin e 3 (tre) personave, ofrues shërbimesh me marrëdhënie pune me kohë të pacaktuar, në pozitat e mëposhtme:

1. Vend pune me emërtimin kurator për arkeologji antike, me titullin e vendit të punës kurator, me kodin KUL 03 04 D03 002 – 1 (një) realizues.
2. Vend pune me emërtimin kurator për periudhën mesjetare dhe osmane, me titullin e vendit të punës kurator, me kodin KUL 03 04 D03 002 – 1 (një) realizues.
3. Vend pune me emërtimin konservator, me titullin e vendit të punës konservator, me kodin KUL 03 04 D03 003 – 1 (një) realizues.

Kandidatët e interesuar duhet t'i plotësojnë këto kushte:

Kushtet e përgjithshme:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut
- ta përdorë në mënyrë aktive gjuhën maqedonase
- të jetë i moshës madhor
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalim për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë ose detyrës

Kushtet e veçanta:

- Për vendin e punës kurator për arkeologji antike dhe kurator për periudhën mesjetare dhe osmane, të ketë arritur së paku 240 kredi sipas ECTS-së ose të ketë përfunduar shkallën VII/1 në fushën e arkeologjisë ose historisë së artit me arkeologji;
- Deri në një vit përvojë pune në profesion;
- Për vendin e punës konservator, të ketë arritur së paku 240 kredi sipas ECTS-së ose të ketë përfunduar shkallën VII/1 në fushën e arkeologjisë, historisë së artit me arkeologji, arteve figurative ose teknologjisë kimike
- Deri në një vit përvojë pune në profesion

Kushte të tjera të veçanta:

- njohje aktive e programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- njohje aktive e njëjës nga tri gjuhët më të përdorura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Kandidatët, së bashku me fletëparaqitjen, duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme (në original ose kopje të vërtetuara te noteri) për plotësimin e kushteve të përgjithshme dhe të veçanta:

- Certifikatë për shtetësi;
- Dëshmi për aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës
- Vërtetim mjekësor (jo më i vjetër se gjashtë muaj);
- Vërtetim/Çertifikat se me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ndalim për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë ose detyrës (jo më i vjetër se gjashtë muaj);
- Dëshmi – Diplomë / Çertifikat për përfundimin e arsimit përkatës

Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut që i plotësojnë kushtet për konkurrim (të përgjithshme dhe të veçanta) .

Orari i punës:

Ditët e punës: nga e hëna deri të premten

Orët e punës në javë: 40 orë

Orari i punës: nga ora 08:00 deri në ora 16:00

Shuma neto e pagës:

Paga mujore neto për kuratorin e arkeologjisë antike dhe kuratorin e periudhës mesjetare dhe osmane është 54.611 denarë.

Paga mujore neto për konzervatorin është 54.611 denarë.

Afati për dorëzimin e aplikimeve:

Afati për dorëzimin e aplikimeve për punësim me dokumentet e nevojshme është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë duke llogaritur nga dita e publikimit të tij në shtypin ditor dhe në faqen WEB të institucionit www.amm.org.mk. Kushtet e cekura në shpallje, kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit.

Fletëparaqitja për shpalljen mund të merret nga arkivi i IN Muzeu arkeologjik i Republikës së Maqedonisë së Veriut - Shkup, me seli në Kej "Dimitar Vllahov" p.n, 1000 Shkup, çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 15:00 ose të shkarkohet nga faqja e internetit www.amm.org.mk.

Kandidatët janë të obliguar që fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, saktë dhe me të dhëna të vërteta.

Mënyra e dorëzimit të aplikimeve:

Aplikimin dhe dokumentacionin e plotë kandidatët mund t'i dorëzojnë me postë në një zarf të mbyllur me shënimin: "Për shpalljen publike për punësim nr. 04/2026 për vendin e punës kurator i arkeologjisë antike, kurator i periudhës mesjetare dhe osmane ose për vendin e punës konzervator", në adresën: Institucioni Nacional Muzeu Arkeologjik i Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup, Kej "Dimitar Vllahov" p.n., 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut, ose në arkivin e IN Muzeu arkeologjik i Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup, çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 15:00, përfshirë ditën e fundit.

Fletëparaqitjet dhe dokumentet e vonuara dhe jo të plota nuk do të shqyrtohen.

Informacion për realizimin e procedurës:

Seleksionimi administrativ për verifikimin e vërtetësisë së të dhënave dhe dëshmive të dorëzuara në shpalljen publike, si dhe realizimi i intervistës në të cilën përmes pyetjeve do të verifikohen kompetencat e nevojshme për kategorinë dhe nivelin të cilit i takon vendi i

punës, do të kryhet nga Komisioni kompetent i formuar për realizimin e procedurës së punësimit. Kandidatët e paraqitur do të njoftohen me kohë për kohën dhe vendin e mbajtjes së intervistës.

Institucioni Nacional Muzeu arkeologjik i Republikës së Maqedonisë së Veriut – Shkup